



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2022:100653

Datë: 22.05.2024

Numri i dokumentit: 05722070

**C.nr.514/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË**, nga Gjyqtari Robert Tunaj, me pjesëmarrjen e praktikantes Saranda Aliaj, në çështjen juridike civile të paditësve: R.L, A.B, H.B, L.S dhe V.V-B, mesimëdhënës ne SH.F.M.U ‘’ 17 Shkurti’’, Sh -S , të cilët sipas autorizimit i përfaqëson Av.I. XH-K nga S, ndaj të paditurës: K e S, D. K e A, me objekt kontesti në emër të pagës në Suharekë me dt.22.05.2024, bie këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**Pa shqyrtim kryesor**

**I. APROVOHET pjesërisht** kërkesëpadia e paditësit: R.L, A.B, H.B, L.S dhe V.V-B

**II. DETYROHET** e paditura D. K E A në S , që paditësit në emër të kompensimit të inflacionit të pagës ,për periudhën **2019 -2021** t’ia paguaj shumat si në vijim:

Paditësi i parë R. L, t’ia paguaj **606,80€** në emër të përqindjes (%) së inflacionit në pagën për periudhën 2019-2021.

Paditësi i dytë A. B, t’ia paguaj **552,65€** në emër të përqindjes (%) së inflacionit në pagesë

Paditësi i tretë H. B, (drejtoreshë) t’ia paguaj **727,80€** në emër të përqindjes (%) së inflacionit pagë për periudhën 2019-2021

Paditësi i katërt L. S, t’ia paguaj **565,20€** të përqindjes (%) së inflacionit në pagë për periudhën 2019-2021

Paditësi i pestë V. V-B, (sekretare) t’ia paguaj **478,20 €** në emër të përqindjes (%) së inflacionit në pagë për periudhën 2019-2021 , të gjitha me kamat ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë me datë:19.05.2022 ,gjerë në pagesën definitive , dhe në emër të shpenzimeve të procedurës për padi 312€ dhe taksa gjyqësore 20€ , të

gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

- III.** Refuzohet kërkesëpadia për pagesën e inflacionit në pagë për periudhën 2017 dhe 2018 për shkak të parashkrimit të kërkesës.

### **A r s y e t i m**

Paditësit: R.L, A.B, H.B, L.S dhe V.V-B, mesimëdhënës në SH.F.M.U ‘‘ 17 Shkurti’’, Sh-S, sipas Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë dhe Ligji i Punës nr.03/L-212.

Gjykata pas vlerësimit të shkresave të lëndës, konkretisht provave materiale të bashkëngjitur padisë, e në kuptim të nenit 8 të Ligjit për procedurën kontestimore, pas çmuarjes me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës prej tyre dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se:

Kërkesëpadia e paditësve, **është e bazuar.**

Në nenin 143 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që:  
*‘‘Me aktgjykim gjykata vendos mbi kërkesën që ka të bëjë me çështjen kryesore dhe me kërkesat aksesore.’’*

Ndërsa në nenin 152 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *‘‘ Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi, i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seancë gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhë nien e tij.’’*

E drejta që në këtë çështje juridiko civile vendimmarrja të bëhet pa shqyrtim kryesor, me të vetëm arsye për zbatimin e ekonomizimit të procedurës, parim ky i sanksionuar dhe i urdhëruar për gjykatën për t’u zbatuar konform nenit 10 paragrafit 1 të Ligjit të procedurës kontestimore, siç parasheh: *‘‘Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.’’*

Në nenin 7 paragrafin 1 të Ligjit të procedurës kontestimore parashihet që: *‘‘Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.’’*

I autorizuari i paditësve, me rastin e ngritjes së padisë, për kompensimin e shperblimi ka bashkëngjitur padisë vërtetimet lidhur me provimin e fakteve për ditët e punës, të cilat paraqiten si bazë për kërkimin e shumave të papaguara.

Nga shikimi i provave: kontratat e punës së mësimdhënësve nr.66/15, 44/17,112,22/1, dhe lista e pagave është provuar fakti se paditësit janë punëtor te e padituara.

Gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, që të ia kompensoj diferencën e pa paguar në pagë, referuar normës së inflacionit dhe atë për vitin 2019 - 2.7 %, për vitin 2020 - 0.2 %, për vitin 2021 - 3.4 % dhe vitin 2022 - 11.6 %, duke u bazuar në dispozitat e nenit 35, pika 10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017 si dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e datës 22.01.2021, që parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit në bazë të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*.

Sa i përket shkallës së inflacionit nëpër vite, gjykata vendosi si më lartë duke u bazuar konform tabelës së inflacionit të lëshuar nga parashtresa e Agjencionit të Statistikave të Kosovës, me numër 01-02-1436, të datës 27.10.2023.

Gjykata është bazuar në mendimin juridik të miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, të datës 09 tetor 2023 në cilin parashihet se *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017 dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit, marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit Sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës”*, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për vitin 2017 dhe vitin 2018, për faktin se padia e paditësit është dorëzuar me datë 19.05.2022. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*.

Vendimin mbi kamatën, gjykata e mori në kuptim të nenit 382 të LMD-së.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në nenin 452.1 të LPK-së duke ia njohur paditësve shpenzimet e procedurës si në vijim: për përpilimin e padisë për paditësin shumë prej 312 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore 20 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi bazuar në nenin 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-DEGA NË SUHAREKË,  
C.nr514./2022 dt 22.05.2024**

Gjyqtari  
Robert Tunaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.